Vdekje fashizmit — Liri Popullit

Poštarina plaćena u gotovu
Taksa postale te paguene

# RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

NEDELNI LIST
FLETORE E PERJAVESHME

Redaksija: Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr 1

PAJTIMET
per 1 vit 96 din
— 6 muej 48 —
— 3 muej 24 —

Dorshkrimet nuk kthehen

Odgovorni urednik XHELADIN
Drejtori pergjegjes HANA

Vjeti IV Nr. 115 | PRISHTINE, 23 Maj 1948 | Çmimi 2 dinarë

## 56 vjetori i dite - lindjes se Pri'sit dhe mësuesit të popujve te Jugosllavis - shokut Tito

Ne ditet vendimtare te historis se popujve te Jugosllavis, kur u-vendos çashtja e ekzistences se tyne jetesore, e liris dhe pamvarsis se tyne - dhe ajo asht vendose shpesh ne teritorin e Jugosllavi, — aspiratat e popujve jane çfaqe nepermjet te njerzve te cilet ne momentin e dhanun kane qene shprehja e tyne ma e plote. Sa ma teper qe kta vigaj te popujve kane mbrri me zgjidhe çashtjen qe ua parashtronte realiteti historik, aq ma te mdhaj ata kane qene, aq ma plotsisht dhe fuqishem kane shprehe madhnin e popullit, jane shkri me popullin dhe jane ba mishnim i plot i aspiratave te tij.

Asnji personalitet ne historin t'one nuk asht ba aq shprehje e plote e virtyteve ma bujare, ma progresive e ma luftarake te popujve t'one, sa shoku Tito. Veç kesaj, ay asht shprehje e aspiratave shekullore te te gjithe popujve t'one — padallim: Serbe e Malazeze, Kroat Maqedonas, Sllovene. Neper Titon dhe ne Titon gjeten zgjidhjen e tyne aspiratat shekullore perparimtare te brezave paraardhese, neper te gjeten zgjidhjen te gjitha çashtjet e ngjan ve t'ona ne Jugosllavi, qe para tij kane qene te pazgjidhuna. Populli e Titoja, qysh kur Tito u-vue ne balle te popullit, si shprehja ma e plote e aspiratave te tija, u-bane dy emna te pandashem, te cilet rrijne dhe do te rrijne krahas gjate te tane historis; sot na nuk mundjeme me e nda njenen prej tjetres: lirin, lindin dhe rrugen kah lumtunija e popujve nga emni i Titos ns madhnin dhe gjenjalitetin e Titos nga populli.

Realiteti i ymë i paraluftes, per shkak te pozites s'one ekonomike — politike, ka kerkue nxanesa te ri te marksizmit per t'a zgjidhe neun e antagonizmave imperjaliste qe kaperthesheshin ne terenin e Jugosllavis, per t'i nxjerre popujt e Jugosllavis nga vallja e aacintsave te jashtem dhe per t'i c r. ne rrugen e shlirimit te plote. Nji naxnes te ketille e dha klasa puntore e Jugosllavis dhe e edukoi Partija Komuniste e Jugosllavis. Partija dhe Tito, qe kur erdhi shoku Tito ne Jugosllavi, me 1937, u-bane dy fjale te pandashme. Asht merite e shokut Tito fakti qe popujt e Jugosllavis fituen nji luftar t'atille militant, me fuqi organizative te çelnikosun, politikisht plot eksperence dhe te pregatitun qe te mund t'orjentohet ne leqet e ndryshme te luftes revolucjonare, siç asht Partija Komuniste e Jugosllavis. Asht merite e tija qe Partija asht spastrue nga elementat e ndryshem oportunista, frakcjonista e anmiqe, shka ka qene parakusht per te gjitha fitoret e saja te pastajme.

Asht merite e Titos qe lufta e jone çlirimtare u-zhvillue si duhet. Emni i tij ne lufte ka qene flamuri luftarak qe u ka pri popujve prej fitores ne fitore luftareve t'one ay u ka frymzue guximin e besimin ne fitore ndersa anmiqeve te popullit — nji frige per vdekje. Tue e zbatue mjeshtrisht marksizem-lenjinizmin ne realitetin t'one, Tito ka zbulue rruget e reja te transformimit revolucjonar dhe ne kushtet e epokes s'one, e ka çue teorin e marksizem-lenjinizmit perpara. Udheheqja e Titos ka ba qe ne Jugosllavi t'arrihet, ne nji menyre specifike, shlirimi i plote i popujve, qe aspiratat e te gjithe popujve t'one, nepermjet te luftes se perbashket kundra anmikut te perbashket, te gjejne zgjidhjen e vet: çlirimin e plote kombtar e shoqnuer. Prandaj shoku Tito asht shprehja ma e plota, mishnimi i aspiratave te popujve te Jugosllavis, biri i tyne ma i madh, qe e ka dhane deri tash historija e jone.

Krijimi i Jugosllavis se re asht i lidhun pazgjidhmenisht me emnin e shokut Tito. Ideja e tij i frymezon luftetaret e Armates s'one. Fryma e tij ndjeke dite e nate punen e pushtetit popullor. Dashunija ndaj Titos asht dashuni ndaj Jugosllavis se re. Tito asht e kaluemja e jone e lavdishme, e tashmja e jone krenare, ardhmenija e jone e ndriteshme. Tito e atdheu jane ba dy kuptime te pandashme.—

Tito asht inicjatori dhe inspiratori i zbatimit te Planit pesvjeçar, ndertimit te socjalizmit ne vendin t'one. Tito ka besue ne fuqit e popullit kur ka propozue hartimin e nji plani te tille. Dhe nuk asht rrejte. Hovi shum i madh punonjes, me emnin e Titos ne goje, nxite masat miljonshe ne pune te vetmohueshme krijuese. Kjo vale e masave popullore asht e forte e luftarake dhe asht ne gjendje qe, nen udheheqjen e Titos, te krijoje me nji ritem te pashembullt dhe t'i shtrydhe te gjithe elementat kapitulluesa, te cilet dalin perpara per me e pengue rrjedhen e zhvillimit te shpejte. Populli i ka pa frytet e para, po i shef edhe shejat, perspektivat e jetes se lumtun te kulturueme e te begatshme, te cilat flojne per fitore te reja pune. Dhe nuk ka fuqi e cila do t'i kthente popujt t'one nga rruga e luftes per realizimin e socjalizmit. Emni i Titos perfaqeson besimin ne fitoren e sigurte. Leva ma e forta per vuemjen ne levizje te masave asht vet eksperijenca e masave, e eksperijenca e popullit ka tregue se Tito e çon kah lumnija e mireqenja.

Besimi ne Titon asht besim n'udheheqesine shtetnore te Jugosllavis se re, ne forcen dhe

## Letra qe i dergohet shokut Tito
### nga popujt e Kosmetit me rastin e ditlindjes se tij

**Shqiptaret, Serbet dhe Malazezet e Kosoves e Metohis te dergojne pershendetje te zjarrta tue shprehe deshiren qe t'i prijsh edhe shum vjete popullit t'one nga fitorja ne fitore kah jeta perhere ma e lumtun e ma e bukur.**

**Te bashkuem, si nji trup i vetem, ne rradhet e Frontit popullor, na marshojme me besim ne rrugen qe na ke tregue Ti ne ndertimin e rendit shoqnuer socjalist. Ne pragun e çdo ditelindjeje t'ande, nepermjet te rezultatevet perhere ma te mdhaja qe korrim vjet per vjet, tue hye gjithnji ma thelle n'ardhmenin socjaliste, ndijme dashni perhere ma te flakte per atdheun t'one - Republiken Federative Popullore te Jugosllavis, e cila, nen udheheqjen t'ande t'urte, asht ba vendi i jetes se lumtun te njerezve te rij.**

**Puntoret e minjerave, fabrikave dhe ndermarrjevet t'ona, katundaret qe ngasin permendet e vjetra dhe traktorat e rij, qe u a ke dhane Ti, rinija nga brigadat e punes te Landovices, Deçanit e Rugoves dhe nga vend-ndertimet e shtepijavet kooperative, afer 80.000 nxanes te shkollave qe na i ke hape, afer njiqind-mij burra e gra, qe kane nxane me shkrue e lexue, inteligjenca popullore qe punon me perkushtim per persosjen e vet dhe arsimimin e popullit, i gjithe populli punonjes, ne hovin e perkushtuem te punes, tue e perforcue vllaznimin e bashkimin e farkuem shoq me shoq, me besim ne fuqit e veta, me dashuni ndaj atdheut, Partis dhe Ty, te betohen, shok i jone i dashtun Tito, se do te punojne pa kursim dhe, se bashku, do t'i a kushtojne edhe mbas tashit te gjitha fuqit permbushjes dhe tejkalimit te Planit pesvjeçar, ndertimit te shoqnis se re socjaliste, forcimit te vllaznimit dhe bashkimit te popujve t'one.**

**Rroona edhe shum e shum vjete, Marshal i jone i dashtun, dhe udhehiqi popujt e Jugosllavis ne fitore te reja, kah lumnija lavdija dhe madhnija.**

**Populli i Kosoves e Metohis.**

## Shtafeta e Titos - manifestim madheshtor i gatshmenis se popujve t'one per realizimin e Planit pesvjecar

Me 25 maj me rastin e 56 vjetorit te ditlindjes se birit ma te madh te popujve t'one-Mareshalit te Jugosllavis, Josip Broz Tito-do te mbrrije ne Beograd stafeta e Titos nga te gjitha anet e Vendit t'one, nga çdo fabrike sipermarrje e vend akcioni pune. Lumej te gjalle te rijsh e te rejash, sulmusa, novatore e racionalizator, luftare t'Armates Jugosllave, puntore, katundare e intelektuale popullore, do te drejtohen me vrapim drejt Beogradit heroik,-per me ia dergue prijsit e mesuesit te dashtun pershendetjet e urimet e popujve t'one.

Por, Stafeta e Titos nuk asht vetem urim, qe bahet ne keso rasash, nuk asht vetem shprehje e dashtunis se pamatun kundrejt birit ma te meritueshem te Vendit t'one. Ajo asht njikohesisht shprehje e besimit te pathyeshem te popullit ne Partin Komuniste te Jugosllavis n'udheheqsin shtetnore, ne Jugosllavin e re. Stafeta e Titos asht shprehje e besimit ne fuqit t'ona, manifestimi madheshtor i gatshmenis se popujve te Jugosllavis per realizimin e Planit t'pare pesvjeçar te ndertimit t'one socjalist.

Stafeta e Titos, ne substancen e qellimin e saje, asht edhe manifestimi i vllazlimit e bashkimit te popujve te Jugosllavis, vllaznim e bashkim ky, qe, i farkuem ne luften Nacional-Çlirimtare, po çelnikoset dita dites ma teper. Stafeta mbahet nga njerez prej te gjithe popujve t'one deri sa te mberrije deri ke shoku Tito. Gjate rruges, mbajtesat e Stafetes do te priten e percjellen gjithkund prej turmave popullore te cilat bashk me ta do t'a kremtojne ne mitingje festen popullore te ditlindjes se prijsit te tyne.

Edhe popujt e Krahines s'one te Kosoves e Metohis, shqiptaret serbet e malazezet, te vllaznuem e te perqafuem do te marrin pjese ne mbajtjen e Stafetes se Titos. Bashke me pershendetjet e fuqin e vendit t'one.

Popujt e Kosoves e Metohis i detyrojne shokut Tito nji mirenjohje te posacme. Akoma e mbajme ne mend te kaluemen e tmerrshme: thiken e pergjakshme te ngatrresave, te ngulun me shekuj, ndermjet popullsinave te Kosmetit. Tash, permbi popujt e perqafuem vllaznisht te Kosmetit qendron emni i Titos. Per 'ta emni i Titos asht sheji se kjo e kalueme ka mbarue nji here e mire. Jeta e re qe po gufon neper fushat, puntorinat dhe shkollat — qe ky asht Tito. Tito asht vet jeta — lirija, socjalizmi. Me emnin e tij dhe per emnin e tij kryhen pune te pashembullta, ndryshon faqja e Krahines s'one dhe shpirtnat e njerezve. Brohoritja TITO — asht brohoritje popullit, vehtes, ardhmenis se lumtun, se sotshmes se sigurte.

Ne historin t'one, e te rralle jane shembujt edhe ne historin botnore, deri tash kurrkend s'e ka rrethue dashunija aq e madhe e masave popullore sa e rrethon Marshalin Tito dashtunija e popujve te Jugosllavis. Me e pa Titon — per cdo njeri don me thane frymezim per hov ne pune, forcim i dashunis ndaj shtetit e popullit. Me fole me Titon — don me thane me fituenji kujtim qe mbetet i vulosun per jete te jetes. Ky takim frymezon jo vetem ata qe e kane jetue, por edhe ata te cilve ua percjellin e tregojne. Ay kthjellon, forcon besimin ne fuqit t'ona dhe ne fitoren e sigurte te çdo çashtjeje, inisjator i seciles asht Tito.

Biograrafija e Titos asht historija e popujve t'one ne periudhen e tyne ma te lavdieshme: periudhen e luftes per clirim dhe per ndertimin e socjalizmit.

Rrnofte prijsi dhe mesuesi i popujve te Jugosllavis — shoku Tito!

(vazhdon ne faqen e dyte)

# Qysh mundet Fronti populluer me e ndihmue tregtin me čmimet e lidhuna

Fronti Populluer ka dhane dhe jep nji ndihme te çmueshme si kudo gjetiu ne zbatimin e tregtis me çmimet e lidhuna. Ketu jane dallue veçanrisht organizatat e Frontit Populluer te rrethit te Prishtines, Liplanit, Podujeves, Mitrovices dhe Gilanit, ku organizatat e Frontit i kane kuptue ma se miri rregulloret dhe ua kane skjarue masave popullore ashtu si duhet, çka na tregojne edhe vet rezultatet. Kurse organizatat e Frontit populluer ne rrethin e Kamenices, Istokut, Rahovecit Suharekes dhe te Drenices nuk kane dhane çka duhet per popullarizimin e skjarimin e sistemit te ri te tregtis me çmimet e lidhuna, çka na tregojne rezultatet jo te knaqshme sidomos persa i perket blemjes se mishit.

Ka organizata te Frontit, si p. sh. ajo e rrethit te Drenices, ku asht harrue tregtija me çmimet e lidhuna krejtesisht, sikur te mos ekzistonte fare, shka jep pershtypjen se atje asht marre tregtija me çmimet e lidhuna si akcjon i perkohshem. Fronti populluer mundet me e ndihmue tregtin me çmimet e lidhuna ne ket menyre.

a) Ne mbledhjet dhe konferencat e veta me i mbledhe rezultatet e mbrrijtuna ne tregtin e çmimeve te lidhuna ne nji katund, ne nji keshill vendi ase ne mbare rrethin, tue e analizue mallin e mbrrijtun industrijal. Nga analiza e perditshme te shifet e te spjegohet se si sistemi me çmimet e lidhuna e permirson standardin jetesuer te turmave te gjana te populsis ne katund e ne qytet.

b) Ne mbledhjet dhe konferencat e veta me e zhvillue nji kritike pozitive konstruktive, tue dhane mundesi me u- vue ne dukje te gjitha dobesit, gabimet dhe leshimet e rrjetes s'one tregtare shtetnore dhe kooperativiste, te drejtorive per blemje, seksjoneve tregtare ekonomike etj., tue i prue ma ne fund konkluzat e nevojshme dhe proponimet per evitimin e shpejt te gabimeve.

c) Me organizue konsultime te gjana te konsumuesve te katundit dhe nga keto mbledhje te bahen porosinat e mallit industrijal, tue u-kujdesue per nevojat e turmave konsumuese, per kualitetin dhe llojin e mallit. Keshtu do t'evitohen gabimet qe jane ba ma pare me porosina nga zyra, pa marreveshtjen me Frontin populluer e pa konsultimin me shtresat e gjana te konsumuesve. Nga kjo ka rrjedhe qe malli i porositun te mos u pergjigjet nevojave te konsumuesve dhe ka mbete i depozituem ne shum vende deri me sot, p. sh. ne magazinat e Kamenices rrijne 50 shporeta, 20 shtreten hekuri e ne Vuçiterne afer 50 cope pllugje; ne Serbice 1536 kemisha dhe 358 pale breke te shkurta te cilat jane kalue prej furnizimit te garantuem ne tregtin me çmime te lidhuna.

Kemi rezerva te mdhaja landesh ndertimi ne Prishtine te cilat, po qe se mbeten edhe ma tutje jashte per t'i rrahe shiu e dielli, do te kalben. Kemi prodhime te ndryshme metalesh, sasina mjaf te te mira konfeksjonesh tekstili Nga ana tjeter (p. sh. Prishtine, Suhareke, Rahovec, Liplan e Dragash) mungojne prodhimet e industris kimike e gadi ne mbare Krahinen mungojne shkrepcat qe ne Vendin t'one gjinden me mjaftuni. Ne keso rastesh asht detyre e Frontit t'i gjeje shkaqet dhe me vigjilancen e tij t'i demaskoje zullumqaret, sabotuesat dhe anmiqet e zhvillimit t'one ekonomik tue marre masa me kohe, sepse nga shembujt e sipertreguem, nga njena ane mbeten pa u-plotsue nevojat e konsumuesave te katundit e, nga ana tjeter, mjetet financjare bllokohen ne malle, i cili fjen neper magazina e keshtu bahet i pamundun veprimi i drejte dhe i sukusesshem i rrjetes s'one tregtare dhe shkaktohet pakanqesi nder konsumuesat t'one.

d) Fronti Populluer mund t'a ndihmoje tregtin me çmimet e lidhuna edhe tue ndermjetsue e influencue, ne rast nevoje qe rrjeta blese tregtare te kujdesohet ma teper per klasifikimin e drejt te mallnave me rastin e blemjes dhe per vendosjen, ruejtjen dhe transportimin e te gjitha prodhimeve te bleme bujqesore.

e) Fronti populluer mundet dhe duhet te ndihmoje shum ne sigurimin e kuadrave per rrjeten tregtare te sektorit shtetnuer dhe kooperativ. Kur paraqitet nevoja te gjinden njerez per kurse te ndryshme ase drejte per se drejti per rrjeten tregare, Fronti duhet me i gjete te rijt dhe te rejat ma te mira, sepse ata jane te thuem qe ne menyren ma direkte t'i sherbejne popullit nepermjet te tregtis se kulturueme socjaliste.

f) Fronti populluer mund te ndihmoje shum ne lufte kundra byrokratizmit si ne aparatin tregtar, ashtu edhe ne rrjeten tregtare te sektorit shtetnuer e kooperativ. Kjo asht nji nga detyrat themelore te Frontit populluer, sepse ne tregti akoma kemi çfaqje te shum ta byrokratizmi, bile mund te thuhet se ma teper se ne deget tjera ekonomike.

g) Lufta kundra spekulimit asht njikohsisht edhe lufte per tregtin e sukseseshme e te drejte simbas çmimeve te lidhuna, per permirsimin e standardit jetesuer te masave te gjana popullore, per mposhtjen e anmiqve te Jugosllavis se re, per ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one. Prandaj kjo lufte duhet te jete detyre e perditshme e Frontit t'one populluer.

Me zbatimin e ketyne detyrave do te shtohet edhe ma teper autoriteti i pushtetit dhe i Frontit populluer, do te forcohen rradhet e tyne, turmat t'ona popullore do t'a kuptojne edhe ma mire drejtosin e politikes qe ndjeke Fronti.

S. Zatriqi

# Hovi i punes ne ndertimin e shtepive kooperative

Puna per ndertimin e shpijave kooperative ne Krahinen t'one asht tue perparue gjithnji ma teper.

Ne rrethin e Gjakoves, Gilanit dhe te Prishtines jane tue marre fund punet pregatitese, e ne rrethet tjera jane pregatite ma se 85% te gureve te nevojshem, 77% gure gelqereje dhe 71% dru per pjekjen e saje. Afer 40% te gelqeres se nevojshme gjindet prane vendeve te ndertimit. Landa e drunit asht pregadit per 73%, rana 60% dhe zalli i trasho 23%. Ne shtate rrethe asht fillue germimi i themeleve dhe ndertimi i mureve. Ne keto rrethe organizatat e Frontit kane dhane 198.415 ore pune vullnetare. Vetem antaret e rinis popullore kane dhane 27.143 ore pune, antaret e FAG-es kane dhane 4.571 ore pune dhe organizatat sindikale 388 ore pune vullnetare. Ne keto rrethe jane dhane edhe 21.652 ore pune me kafshe terheqese. Rezultatet ma te mira jane mberijte nga organizatat e Frontit populluer te rrethit te Gjakoves, Gilanit, dhe Prishtines.

Nga puna e deritashme asht konstatue se ne shume vende mungon fuqija puntore eksperte. Ky asht nji problem qe duhet te zgjidhet sa ma pare. Ky mvaret kryesisht nga aftesija e orjentimit te kooperativave dhe te drejtorive per ndertimin e shtepijave kooperative. Kjo fuqi puntore mund te sigurohet tue i aftesue te rijte me anen e kurseve te ndryshme me ndihmen vullnetare t'antareve te sindikates dhe tue i marre ne pune te gjithe mjeshtrit muratore te katundeve, te cilet jane ende pa pune. Persa i perket sigurimit te fuqis eksperte asht e nevojshme me i angazhue ingjinjeret, tekniket dhe mjeshtrit ma te mire qe punojne neper sipermarrje. Shembullin e ingjinjereve e teknikeve te sipermarrjeve botore „Graçanica" dhe „Sitnica", te cilet kane marre persiper me i vizitue vazhdimisht shtepijat e aferme kooperative, duhet t'a ndjekin edhe ekspertat e sipermarrjeve tjera. N'anen tjeter drejtorinat e ndertimeve duhet t'i angazhojne edhe mjeshtrit qe punojne jasht sipermarrjeve. Gjithashtu edhe deget sindikale te rretheve tjera duhet t'a ndjekin shembullin e atyne te rrethit te Prishtines, te cilat kane dhane obligime te mira per t'a ndihmue ndertimin e shtepijave kooperative.

Per te muejt me e shpejtue punen e ndertimit te shtepijav kooperative, drejtorinat e ndertimit duhet te perbahen nga numri i nevojshem i antareve dhe te bajne çmos per cfrytzimin dhe adaptimen e drejte te fuqis puntore si edhe per vendosjen e lidhjeve ma te ngushta me organizatat Frontit populluer, te cilat e kane kuptue randesin e ketij akcjoni dhe jane gadi me kontribue per realizimin sa ma te shpejte te kesaj detyre te randesishme ne vjetin e dyte te Planit pesvjeçar.

## Mbi disa te meta ne zbatimin e rregullores per blemjen e leshit

Ne rrethin e Prishtines asht konstatue se komisjonet e vendit e kane ba caktimin e leshit, tue pase besim se pronaret e kane tregue numrin e vertete te dheneve. Me rastin e kontrollimit ne reonet e keshillave te vendeve Obiliq e Sllvove, jane gjete 100 cope dhene te meshehuna, ne Jugoviq 20 cope, ne Fushe-Kosove 15 cope etj. Kjo asht vetem nji pjese, mbassi kontrollimi asht tue vazhdue ende. Peveç kesaj, komisjonet nuk e kane ba caktimin e drejte te leshit. Keto, ne disa raste jane largue nga Rregullorja dhe i kane lirue pronaret qe detyrohen me dorzue nen 400 gram; e n'anen tjeter disa pronareve i u kane caktue ma shum se sa parashifet me Rregulloren. Kjo ka ngja ne Mareve, Sllvove e Devet-Jugoviq. Rregullorja parashef qe te mos kerkohet leshi per dhenet e shituna me çmimet e lidhuna, e komisjonet e vendeve te permendluna nuk i jane permbajte as kesaj dispozite.

Te tilla leshime dhe te meta ka edhe neper vendet e tjera te Krahines s'one, prandaj asht e nevojshme qe te merren masat e shpejta per zhdukjen e tyne, e me ndihmen e organizatave te Frontit, te luftohet vazhdimisht per zbulimin e vertete te dhenve, dhe pronareve t'iu spjegohet si randosija e Rregullores ashtu edhe mosnyra e arkimit, me rast te ndonji padrejtesije.

# Seksjonet e punve komunale nuk ia kane kushtue kujdesin e duhun forcimit t'ekonomis lokale

Per t'i çduke te metat dhe per t'a vue punen e ekonomis lokale ne baze ma te forte e ma te drejte ne Prishtine u-mbajte konferenca e te besuemve te seksjoneve komunale prane keshillave te rretheve e te qyteteve dhe kryetarve te komisjoneve te planeve. Ne konference asistuen ministri i puneve komunale te R.P. te Serbis me ndihmesin e tij dhe i besuemi i Drejtoratit Komunal te Keshillit Krahinuer.

Ne konference u konstatue se seksjonet komunale nuk jane marre seriozisht me forcimin e ekonomis lokale dhe aq ma pak u kane kushtue kujdes problemeve komunale. Gadi te gjithe te besuemit u a kane lane drejtorave te sipermarrjeve kujdesin mbi ket ekonomi dhe fare pak ase aspak nuk i kane kontrollue keto.

Vet-inisjativa per hapjen e sipermarrjeve me karakter lokal ka qene e mire gadi ne te gjitha vendet, por edhe ketu ka pase leshime sepse disa seksjone komunale nuk i kane hetue mundesinat e fitimit te landeve te para nga burimet lokale, por jane formue sipermarrje pa pase mundesi qe keto te furnizohen nga burimet e saja. Te besuemit e seksjoneve komunale shum pak e kane kontrollue punen e sipermarrjeve qe kane qene nen udheheqjen e tyne operative. Per mungese te ketij kontrolli ka rrjedhe qe disa mullij, fabrika tullash e puntorina nuk kane punue si duhet. I besuemi i seksjonit komunal ne Podujeve ua ka lane ekonomin drejtorave te cilet e kane keqperdorue. Per shembull drejtori i fabrikes tullave ka marre me vedi 100.000 dinare me te cilat ka veprue si ka dashte ne Beligrad, e arktari i tij ka mbajte neper xhepa me nga 50.000 dinare, gja qe asht e ndalueme me ligj. Nikolla Mihajllo. viq e ka prishe mullinin aq keq sa nuk mund te ndreqet, e nuk jane marre masa me kohe per t'i pengue keto ngjarje. Kreditet jane shpenzue pa vend.

Gjetja e landeve te para per industrin lokale asht prite nga jashti -nga kontigentet e Ministris ase te Keshillit Krahinuer. Gadi asnji i besuem nuk asht kujdesue sa duhet per t'a zgjedhe problemin e landeve te para nga burimet lokale. Ato puntorina qe e kane planin e prodhimit, shum pak jane kujdese me e gjete vet materjajin e duhun. Puntoret e puntorinave dhe te sipermarrjeve te cilet kane prodhue, jane leshue nga puna per mungese te landeve te para, ndersa drejtorat dhe personeli tjeter administrativ kane mbete edhe mandej ne barre te sipermarrjes. Te besuemit e seksjoneve komunale nuk e kane kuptue se udheheqja n'ekonomin lokale asht detyre e tyne kryesore. I besuemi i punve komunale ne qytetin e Prishtines e ka kufizue punen e tij ne zgjidhjen e çashtjes se banesave, ndersa problemet e ekonomis lokale u a ka lane ne dore drejtorinave te sipermarrjeve.

Ma se miri e ka drejtue punen Mitrovica, me gjithe se edhe atje jo ashtu siç ka muejte me qene. Puntorija e maqinave ka çfrytezue hekurin e vjeter dhe keshtu nuk e ka ndalue punen. Kjo puntori disponon vegla te mira, por seksjoni komunal duhet te kujdeset per t'i gjete materjal. Ne Peje puntorija zdrukthetare nuk çfrytezon as 20% te maqinave sepse nuk ka lande e kerkund nuk mund te gjinden lande ma lehte se ne Peje e Mitrovice.

Nuk i asht kushtue kujdes i duhun hapjes se sipermarrjeve te reja, konkretisht hapjes se sipermarrjeve te gelqeres. Gelqerja asht shum e nevojshme per punet t'ona botore, e disa rrethe detyrohen t'a sjellin nga jashte me gjith se kane mundesina me e prodhue vet.

Hapja e minjerave te linjit lokale te qymyrit, i cili gjindet ne shumicen e rretheve, duhet t'a siguroje furnizimin e qyteteve me lande djegese dhe t'a ndihmoje industrin t'one lokale. Kjo asht nji detyre e randesishme me te cilen duhet te meret edhe Fronti Populluer.

Fronti Populluer dhe organizatat tjera masovike deri tash i kane dhane ndihme te madhe ekonomis lokale ne zgjidhjen e problemeve komunale, por duhet t'angazhohen edhe ma teper per te gjete lande te para per ekonomin lokale, duhet t'a ndihmojne organizimin e sipermarrjeve te gelqeres si dhe punen e furrave te tullave e te tjegullave dhe furrave te gelqeres etj. Duhet te gjejne forma te reja pune dhe menyra te reja prodhimi, keshtu qe prodhimi t'i plotesoje nevojat lokale.

(vijon nga faqja e pare)

urimet ma te fjaktat, do t'ia dergojne Mareshalit te dashtun Tito dhe premtimet e ngulta se do t'i vejne te gjitha fuqit e veta per me e nxjerre Krahinen e tyne nga mbrapambetunija, ku e kane lane regjimet kundra popullore t'ish Jugosllavis dhe okupata e zeze fashiste. Populli e Kosmetit jane te vetedijshem se deshira ma e madhja e Marshalit Tito asht qe Republika Federative popullore e Jugosllavis, mos te kete republika popullore, krahina e vise te mbetuna mbrapa njena tjetres. Kjo deshire e madhe e Mareshalit Tito qe edhe Krahina e jone te shkoje krah per krah, e perparueme, me te gjitha viset e tjera te Vendit t'one, shifet e kjarte nga te gjitha ndermarrjet e shumta e akcjonet e punimeve ne Kosmet, shifet nga numri i madh i shkollave, kurseve bibljotekave, kinemave, shoqnive kulturo-artistike etj., qe po shtohen dita dites.

Populli e Krahines do ta shprehin dashunin e mirenjoftjen edhe me punen e vetmohueshme jashta Kosmetit ne ndertimin e Beogradit te ri, t'autostrades „Vllaznimi e Bashkimi" te qytetit industrijal ne Zheleznik e n'akcjonet e tjera gjate e gjane ne Vendin t'one ku jehon kanga gazmore e shoqnuem nga tinguji e harmonishem te kazmes, lopates çekicit, drapnit, nga fishkullimi i lokomotivave, fabrikave elektrike traktorave kombajnave etj., sepse jane koshjente se perparimi i republikave popullore don te thot edhe perparim i Krahines s'one e anasjelltas.

Stafeta e Titos do te jete nji nxitje per hove edhe ma te medhaja puneje te popullit ne Kosmet, per realizimin e detyreve te Planit pesvjeçar te Titos, ne luften e perditshme dhe te pameshirshme kundra spekulantave, sabotuesve byrokratve kundra te gjithe anmiqve te popullit-rrmisave te kesaj lirije e barazije, te jetes se lumtun qe po e ndertojme ne komunitetin e popujve te barabarte — Republiken Federative Popullore te Jugosllavis.

Anmiqve te popullit, veglave t'imperjalizmit amerikan na iu pergjigjemi, me pune te vetmohueshme ne realizimin e Planit pesvjecar, mbassi sa ma forte ndertohet Vendi i yne, aq ma teper i shtohet fuqija e tij e aq ma te pafuqishme bahen mbeturina anmike.

H. Tufa

# Nga jeta kulturalo-arsimore

## Komunikate e Drejtoris se Bashkimit te letrarve te Jugosllavis

Me deshire qe te shpejtesohet mbledhja e poezis mbi okupacjonin gjermano-fashist dhe mbi luften t'one çlirimtare, si dhe per t'i ndihmue drejt per se drejti njerzit nga populli qe hartojne kange lahute ase lirike mbi okupacjonin dhe luften shlirimtare, -Drejtorija e Bashkimit te letrareve te Jugosllavis ka formue nji komisjon te posaçem per mbledhjen e kangeve popullore mbi luften Nacional-Çlirimtare.

Ky komisjon apelon ne te gjithe mesuesat e popullit, udheheqesat e shoqnive kulturore, ne te gjithe njerezit alfabete ne popull, ne te gjitha institutet dhe organizat kulturore dhe arsimore, - te mbledhin kange popullore mbi okupacjonin dhe mbi luften t'one Nacional-Çlirimtare, mbi ushtrin t'one popullore dhe udheheqesat t'one, e keto kange -tue shenue pikrisht se prej kujt dhe ku i kane marre,- t'ia dergojne Bashkimit te letrarve te Jugosllavis, Beograd, Francuska Nr. 7, tue shenue se jane per komisjonin e permendun.

Bashkimi i letrarve te Jugosllavi fton te gjithe njerzit nga populli qe kane komponue potpuri kangesh lahute ase grash, ase vetem kange lahute e grash mbi luften çlirimtare kundra okupatorit dhe sherbetoreve te tyne te mbrendshem,- t'ia dergojne komisjonit te bashkimit te letrareve te Jugosllavis.

Bashkimi u ban apel te gjitha organizatave te Frontit popullore, te rinis popullore Frontit Antifashist te grave, Bashkimit te pionerve te Jugosllavis - t'i perdorin ne ket pune te gjitha eksperiencat dhe hovin e tyne, si e si te shpetohet sa ma shum pasuni e re letrare e popullit nga harresa dhe t'i falet mbare vendit dhe breznive t'ardheshme.

## Si e çmojne arsimin katundaret e Verbon-it ne rrethin e Ferizajt

Ne mes te malit te Zi te Kaçani kut gjindet katundi Verbaņ, i cili ka gjithsejt 80 shtepi.

Si ne kohen e Jugosllavis se vjeter ashtu edhe gjate okupacionit bullgar, ky katund nuk ka guxue te kete shkollen ne gjuhen amtare. Mbas çlirimit te Vendit t'one, me interesimin e Frontit Popullor i cili perpiqej me e plotesue deshiren e katundarve tue a çele syte femijve te tyne, u-hap shkolla dhe u-caktue mesuesi i posaçem per ket katund. Me inisjativen e Frontit Popullor u-organizue puna e meremetimit te nji ndertese per shkolle, plotsimi i bankave dhe i orendive te tjera te shkolles. Katundaret nuk kursyen te ndihmojne per shkollen e tyne: mblodhen 4900 dinar tue i sigurue bankat e shkolles, mblodhen 400 Kgr. grune e miser, te cilen sasi tue e shite me çmimet e lidhuna muejten me ble gozhda, xhama etj. Ma teper nder te gji the asht interesue dhe ka ndihmue katundari Musfaf Azem Vishi.

Sot shkolla asht mjaft e rregullte. Mesimet i vazhdojne rregullisht 70 nxanes e nxanese nder tri klasa te ndryshme.

Gjate dimnit ketu ka punue edhe kursi analfabetik. Prej 100 te rijve e te rejave kane mesue te shkruejne e te kendojne 90 vete.

Tashma katundi verban nuk asht ai qe ka qene para disa vjetve: katundaret punojne e pushojne me qef, te rijt e te rejat perpiqen me u-aktivizue ne çdo akcion te Frontit, femijt mesojne me deshire te madhe ne gjuhen amtare e kthehen nder shtepija te gezuem per sukseset qe korrin ne shkolle.

Qe, pra, si shkon perpara katundi, kur Fronti e udheheqe mire dhe kur katundaret kane vullnet e deshire per perparim.

## Film dokuméntar mbi jeten e shqiptarve ne Kosmet

Sipermarja "Avalla,, e filmave ka fillue me e fotografue filmin e pare dokumentar mbi jeten e shqiptarve ne Kosmet Fotografimi i fillmit ka fillue me u-ba n'Istok dhe aty do te perfundohet.

Skenarin per film e ka shkrue letrarja Frida Filipoviq. Permbajtja e filmit asht plotesimi i planit t'organizates se Frontit Popullor ne çdo sektor pune.

Filmi fillon me tregimin e punimeve ne ndertimin e centralit elektrik n'Istok, qe asht tue e ndertue Fronti dhe pushteti popullor, dhe do te perfundoje me kange e valle popullore me rastin e vuemjes ne levizje te hydrocentralit, kah mbarimi i muejit qershuer te ketij viti.

Nder keto dite, sipermarrja ne fjale çfaqi tre filma per popull: „Sllavica", „Luften kundra tuberkulozit", dhe disa cope te filmit qe po pregatitet n'Istok. Katundaret mbeten shum te knaqun e sidomos atehere kur e pane vedin ne film dhe shoket e tyne tue punue nder ara ase nder akcionet e Frontit, si ne centralin elektrik etj. Keta, tashma kane fillue t'i çmoj ne mire filmat sepse e provuen ne vetvedi qe s'qenka gja shprehja e disa injorantave qe thone se: „ne pelhure luejne e flasin dreqnit" Nuk asht per t'u çudite edhe forte qe disa katundare a qytetare t'a paraqitshim keshtu filmin mbassi ne kohen e Jugosllavis se vjeter dhe n'ate t'okupacionit, filmat nuk kane pase qellime edukative dhe qe t'i ngrejne masat kulturalisht kurse sot ndodhe e kunderta sepse nepermjet te filmave masat popullore mesohen, edukohen dhe i shtojne perpjekjet e veta per te krijue dite per dite kushte ma te mira per jeten e re ne Vendin t'one.

### *Koncerti i grupit t'artistave te Beogradit ne Prishtine*

Grupi i artistave te Beogradit i perbame prej Pjanistes Olga Popov, sopranit Ivana Tavçar, violinistit Bogomir Gorse dhe antarit t'Operas se Beogradit Jovan Gligorijeviq, ne turnejeu e tij neper Republiken Popullore te Serbis, vizitoi edhe Kosmetin. Ne Mitrovice e Prishtine artistat dhane koncerte te sukseseshme. Publiku i Prishtines dhe Mitrovices pati mundesin me ndigjue veprat e famshme muzikore te kompozitorve te famshem botnore e te vendit t'one siç jane Shopen, Rimski Korsakov, Dvorzhak, List, Çajkovski, Gotovac, Binięki, Pavçiq dhe Caniq.

Seksjoni kulturo—arsimuer i Frontit popullor te qytetit te Prishtines nuk i ka dhane as ma te voglen randesi koncertit. Kete e dishmon fakti se scena ne mbramjen e pare te koncertit ka qene krejt e pa pregatitun.

### Grupi folkloristik i Shqipnis ne Jugosllavi

Para disa ditesh ne Jugosllavi erdhi si mysafir grupi folkloristik shqiptar nga Shqipnija i perbame prej 53 vetash Grupi folkloristik shqiptar deri tash ka dhane çfaqje ne Titograd, Cetinje, Herceg-Novi, Mostar, Sarajeve, Zenice, Zagreb, Ljubljane, Borovo e Beograd. Ky grup do te jape çfaqje edhe ne Nish, Shkup e Manastir.

## Ne Prishtine u-formue shoqaija kulturo-artistike shqiptare „Ramiz Sadiku"

Ne keto dite u-mbajte ne Prishtine Asambleja themeluese per formimim e shoqnis kulturo-artistike shqiptare. Asamblen e hapi shoku Sherafedin Sulejmani, Kryetar'i Rinise popullore te qytetit Prishtine. Shoku Nexhip Habibaj mbajti nji referat, me te cilin vuni ne dukje randesine dhe qellimin e kesaj shoqnije, e cila do te luej nji rrol te madh per ideologjike dhe kulturale te masave te gjana shqiptare ne perforcimin e vllaznimit dhe bashkimit me popujt e tjere te Krahines dhe t'Atdheut t'one pergjithesisht, nepermjet te perpjekjeve te perbashketa per ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one.

Shoqnija do t'i kete seksione: dramatik, koralo-muzikuer dhe folkloristik. Asambleja, mbas proponimit te keshillit kandidues aprovoi njizanit pagezimin e shoqnise me emnin e Heroit te popullit, Ramiz Sadiku.

Menjihere filloi rregjistrimi i antarve te kesaj shoqnije.

## Nga jeta e pakicave kombtare ne atdheun t'one te lire

Opera e thatros popullore ne Fiume e vetmja ne vendin t'one jep çfaqje ne te dyja gjuhet—italisht e serbisht. Vllaznimi i popullit italjan e kroat n'Istra e Fiume, pasqyrohet veç tjerash edhe ne perbamjen nacjonale dhe ne punen e theatros popullore. Artistat italjanë e kroatë punojne s' bashku per realizimin e qellimit te perbashket—me ua afrue artin theatral masave te gjana kroate e italjane t'Istres e Fiumes. Keta japin s' bashku opera e drama ne te dyja gjuhet. Ma se 50 per qind e t'artistave jane italjan.

Keto dite Shpija Botuese, ne saje te perpjekjeve t'Unionit italjan, botoi librin «Italjanet ne RFPJ» ne gjuhen italishte. Ky liber permban ma se 20 artikuj te ndryshem ne lidhje me jeten dhe punen e italjaneve ne Jugosllavin e re ç'prej kohes se luftes se perbashket kundra fashizmit e deri me sot.

## Kinemate

Kinema »Rinija« Prishtinë
prej dates 24—26 Maj:
»Kino koncertit sovjetik«
prej dates 27—30 maj:
»Pasunija e lugines se cilit«

Kinema „Dom kulture" Stari Trg, prej dates 20—23 maj: Kthesa e madhe, prej dates 26=30 maj: Kapiteni 15 vjeçar.

Kinema e tunelit, afer Mitrovices prej dates 20—23 maj: »Kthesa e Madhe«, prej dates 26—30 »Kapiteni 15 vjeçar«.

Kinema »Lirija« Ferizaj
prej dates 24—26 maj:
»Vajza nga mali« prej date 26—30 maj:
»Aleksandar Nevski«

Kinema »Hysni Zajmi« Gjakove
prej dates 26—27 maj:
»Kutozov«
prej dates 28—31 maj:
»David Buramishvili«

Kinema »Palas« Mitrovice
prej dates 24—27 maj:
»Pa miraz«
prej dates 28—31 maj.
»Perfaquesit i pushtetit«.

Kinema »Kosova« Obiliq
prej dates 28—30 maj:
»Valeer'i bardhe«

Kinema »Zveçan« Zveçan
prej dates 25—26 maj:
»Perfaqesuesit i pushtetit«.

Kinema »Ardhmenija« Podujeve
prej dates 21—23 maj:
»David Buramishvili«

Kinema e Prizrenit ne shpin e kultures prej dates 25—27 maj:
»David Buramishvili«
prej dates 28—31 maj:
»Taxhikistani«

*NJI SUKSES SHEMBULLOR*

## Me inisjativen e Frontit Popullor te rrethit te Gjakoves shpetojne prej brymes 90% te pemve

Tue qene se mueji prill mori me shina dhe njikohsisht me pak te ftofet, sidoemos naten, Fronti Popullor i rrethit te Gjakoves, tue pa se mund te rrezikoheshin pemet prej ndonji bryme qe eventualisht mund te binte, ndermori qe te bajne nji akcjon tue formue ekipa nder katundet e rrethit si dhe nder lagjet e qytetit. Keto ekipa nder ditet 27 dhe 28 prill grumbulluen nder kopshtije kashte, sane te kalbet dhe talle misri. Per çdo grup 10-20 shtepijash, ekipa caktoi nji roje, e cila ruente naten, dhe ne rast te çfaqjes se brymes ajo te lajmeronte çdo shtepi, ne menyre qe te kalleshin grumbujt e pregatitun Nder vende ku kishte vade, te leshohej kjo, mbassi edhe kjo e ban efektin gadi njilloj si te tymit.

Cka parashifej, ashtu ngjau: ne mengjes te dates 29 prill rojtaret dalluen çfaqjen e brymes, e lajmuen populsin per t'i ndeze grumbujt dhe per te leshue vaden, keshtu qe me tymin e grumbujve dhe me avullin e ujit nuk u-lejue qe bryma te zinte vend nder deget dhe fletet e pemve. Ne kete menyre shpetuen prej ketij rreziku 90% te pemve te rrethit e te qytetit, me perjashtim te katundeve Vraniq, dhe Dobjibare te keshillit popullor te vendit Bec, banoret e te cilave nuk e zbatuen akcjonin e kolektivitetit, gja e cila shkaktoi qe ne keto katunde te damtohen pemet gadi 100%.

Me ndermarrjen e ketij akcioni te Frontit popullor dhe me vullnetin e mire te kopshtarve shpetuen ma se 100 vagona peme te ndryeshme me nji vlefte ne ma se 4 miljon dinaresh.

M. Kadiu

### Puna e brigadave te rinis ne rrugen Kuqishte — Boge

Qysh me 12 prill te ketij vjetit dy brigada puntore te rinis: Brigada "Emin Duraku" nga rrethi i Ljipjanit, e perbame prej 216 te rijve e 20 te rejave, dhe Brigada e 1-rë e Vuçiternes, e perbame prej 95 te rijsh e 15 te rejash, filluen me ndertue rrugen lokale industrijale Kuqisht—Bogë, te gjate 8 kilometra. Me punen e tyne te vetmohueshme te rijt e te rejat e ketyne brigadave kane gropue deri tash gjithsejt 6070 kubikë dhe. Keta jane zotue se rrugen do ta mbarojne mbrenda afatit te caktuem-mbrenda dy muejve.

As puna kulturo-arsimore ne keto brigada nuk mbetet mbrapa:- disa arsimtare, veç tjerash, u kane mbajte brigadistave disa thema te ndryshme edukative.

Q. GRACENI.

## Ndeper vend-verimet e Kosmetit do t'a kalojne pushimin 1200 femij

Drejtorati social i Kshillit krahinuer te Kosmetit do te hapi ne ket vere 7 vend-verime per femijt e shkollave t'ona: ne Kerpime, rreth i Podjeves, Mushitisht, reth i Suharekes, Vrelle, reth i Istokut, Nerodimlje rreth i Ferizajt, Strelc, reth i Pejes, Komoran, rreth i Prishtines dhe ne Binaç, rreth i Gjilanit.

Veç kesaj shum femij nga Krahina jone do te verojne neper vend-pushime qendrore e republikane te Jugosllavis e Serbis.

Te gjitha kushtet per hapjen e ktyne vend-verimeve jane sigurue. Inventari dhe nderteSat jane sigurue. Ma se 75 per qind femi qe do te gezojne pushimin jane te vobegte dhe nuk do te paguejne kurrgja e te tjeret do te paguejne simbas fuqis ekonomike — nga 500 ase 250 dinare per nji muej.

Drejtorinat e kytene vendverimeve do te perbahen prej mesuesave pedagoge. Sivjet do te verojne bashk nxanesit e shtepijave te femijve me nxanesit e qyteteve e katundeve, nxanesit shqiptare me nxanesit serbe e malezeze. Ne ket menyre brezi i jone i ri do t'a thelloje bashkimin e vllaznimin, nxanesit e qyteteve e katundeve, si te jashtem, do te njifen me edukaten qe kane fitue femijt t'one neper strehat e femijve.

Asht detyre e organizatave te Frontit te vendit qe te japin çdo ndihme, sidomos ne gjetjen e femijve ma te vorfen dhe ne sigurimin e pastertis dhe nevojave tjera neper vend-verime.

## Ndigjoni emisijonet ne gjuhen shqipe

RADIO PRISHTINA
ne vale te mesme 285 metra

Çdo dite n'oren 18.30 — Ijame nga Kosmeti
Çdo dite n,oren 19.30 — Permbledhje e shtypit;
Te hanen, merkuren e te premten n'oren 20-ora e arsimit popullor;
Te marten n'oren 20-„Nga Bashkimi Sovjetik";
T'ejten n'oren 20-Kronike kulturore;
Te shtunden n'ora 20.30-kronika e ngjarjeve politike te javes
Te djelen n'ora 20-emisjoni per femij.

RADIO BEOGRAD

Lajme ne gjuhen shqipe transmeton dy here ne dyte:
n'oren 14,45 ne vale te shkurta 31,56 metra dhe
n,oren 17.15 ne vale te shkurta 58,18 metra.

# Nga situata nderkombtare

**Marredhanjet Sovjeto — Amerikane**

## Pergjegja e Gjeneralisimit Stalin letres se Henri Valasit

Para disa ditesh Henrih Valas, kandidat i Partis se trete per prezident te Shteteve te Bashkeme t'Amerikes, i dergoi gjeneralisimit Staljin nji leter te hapet ne te cilen paraqet masat qe, simbas mendjes se tij, duhet te marrin te dy shtetet-si SH. B. A. ashtu edhe BRSS-per permiresimin e marredhanjeve nderkombetare, per ndreqjen e mosmarreveshtjeve ndermjet tyne, per krijimin e paqes se qindrueshme ne bote dhe per sigurimin e demokracis.

Gjeneralisimi Staljin i dha Vallasit ket pergjegje:

"Konsideroj se dokumenti ma i randesishem ne serin e dokumenteve politike te botueme ne kohen e fundit, te cilat kane per qellim forcimin e paqes, krijimin e bashkpunimit nderkombetar dhe sigurimin e demokracis, asht letra e hapet e z. Vallas, kandidat i Partis se trete per prezident te Shteteve te Bashkueme t'Amerikes.

Letra e hapet e Vallasit nuk mund te konsiderohet si deklarim i thjeshte deshire per permiresimin e situates nderkombetare, deshire per rregullimin paqesuer te mosmarreveshtjeve ndermjet BRSS e SHBA, deshire per gjetjen e rrugave per rregullim te ketille. Deklarata e qeveris se Shteteve te Bashkueme t'Amerikes e 4 Majit dhe pergjegja e qeveris se BRSS e 9 Majit nuk jane te plota sepse nuk shkojne pertej shprehjes se deshires per rregullimin e mosmarreveshtjeve sovjeto-amerikane.

Randesija e madhe e letres se hapet qindron ne faktin se ajo nuk kufizohet si deklarate por shkon ma larg, qet nji hap serjoz perpara dhe jep program konkret per rregullimin paqesuer te mosmarreveshjeve ndermjet BRSS e Shteteve te Bashkueme t'Amerikes.

Nuk mund te thuhet se letra e hapet e Vallasit i perfshin te gjitha mosmarreveshtjet pa perjashtim. As nuk mund te thuhet se ne disa formulime e komentime ne letren e hapet nuk nevojiten permiresime, por tash kjo nuk asht kryesorja. Gjaja kryesore asht se Vallasi ne letren e tij ban perpjekje te hapet dhe te ndereshme per me dhane program konkret per rregullimin paqesuer, ban propozime konkrete mbi te gjitha çashtjet e mosmarreveshtjeve themelore ndermjet BRSS e Sh.B.A.

Keto proponime i njofin te gjithe: pakesimi i pergjitheshem armatimit dhe ndalimi i armes atomike, lidhja e traktatit te paqes me Gjermanin e Japonin dhe terhjekja e trupave nga keto vende terhjekja e trupave nga Kina e Koreja, nderimi i sovranitetit te vendeve te ndryshme dhe mosperzjerja ne çashtjet e tyne te mbrendeshme, ndalimi i bazave ushtarake ne vendet-antare t'Organizates se Kombeve te bashkuem, zhvillimi i gjithaneshem i tregetis nderkombetare e cila perjashton çdo diskriminacion, ndihma dhe rindertimi ekonomik, ne kuadrin e Organizates se kombeve te bashkuem, i vendeve te damtueme nga lufta, mprojtja e demokracis dhe sigurimi i te drejtave civile ne te gjitha vendet, etj.

Mund te pajtohemi ase te mos pajtohemi me programin e Vallasit. Por, me gjithate, nji gja asht e padyshimte: asnji burre shteti qe perpiqet per paqen dhe bashkpunimin e popujve nuk mund t'i shmanget ketij programit sepse ky shperhe shpersat dhe aspiratat e popujve per forcimin e paqes dhe pa dyshim, do te gezoje perkrahjen e shum miljona „njerezve te thjeshte".

Une nuk dij a thue qeverija e Shteteve te Bashkueme t'Amerikes e pranon programin e Vallasit si baze per marreveshtje ndermjet BRSS e SH. B. A. Persa i perket qeveris se BRSS, ajo konsideron se programi i z. Vallas mund te sherbeje si baze e mire dhe frytedhanese per marreveshtje te tille dhe per zhvillimin e bashkepunimit nderkombetar, sepse qeverija e BRSS konsideron se, pa marre para sysh ndryshimin ndermjet sistemeve ekonomike e ideologjike, koekzistenca e ketyne sistemeve dhe rregullimi paqesuer i mosmarreveshtjeve ndermjet BRSS e SH. B. A. jo vetem jane te mundun por edhe te domosdoshem n'interes te paqes se pergjithshme.

## Mbare shtypi botnuer u kushton keto dite kujdes te madh ngjarjeve ne Palestine

Mbassi deshtoi mandati i Britanis se madhe ne lidhje me Palestinen, dhe simbas vendimeve te Kombeve te Bashkuem, trupat britanike e leshuen Palestinen me 14 te k. m, dhe po ne ket dite u-proklamue ndamja e Palestines ne dy shtete te pamvarun — ne shtetin Izrael e Arab. Me 15 Maj, simbas lajmeve te Rajterit, qeverinat e Libanit, Egjyptit, Siris e Irakut, njoftuen sekretarin e pergjitshem t'Organizates se Kombeve te Bashkuem se kane vendose me u-shpalle luft çifutve te Palestines dhe te bashkohen me operacjonet ushtarake qe i drejton qysh para dhete ditesh komandanti suprem i Transjordanis, anglezi Glab-Pasha ne Palestine. Pra, ne ket vend hyni perseri ushtrija e re e okupacjonit, me oficerat britanik ne krye. Ktu del e kjarte se imperjalistat britanik dishrojne qe edhe mbas vendimit t'Organizates se Kombeve te Bashkuem me i ruejte pozitat, investicjonet e kapitalit dhe ne rend te pare, bazat ushtarake dhe ato te naftes. Ket here rol i gjindarmit kolonjal u asht ngarkue udheheqsave reakcjonar te vendeve fqinje arabe. Amerikanet kane investicjone te mdhaja ne Palestine, te cilat ne shumicen i kane te perbashketa me çifutet. Pjesa ma e madhe e kapitalit te sipermarrjeve elektrike „Gjeneral elektrik" dhe e sipermarrjes „Potasha limited", e cila nxjerre nga deti i Vdekun minerale te çmueshme, gjindet ne duer te Volstritit. Prandaj SH. B. A. deri ne ditet e fundit te hjekjes se mandatit britanik jane perpjekë me te gjitha fuqit per anullimin e vendimit te O. K. B. mbi ndarjen e Palestines dhe, ne vend te pamvarsis, t'a lane ate perseri nen regjimin kolonjal ne forme „ kujdestarije". Kur deshtoi ky plan ne komitetin politik t'Asamblės gjenerale, presidenti Truman vrapoi me e njofte qeverin e pare te perkohshme t'Izraelitve. Tue komunikue ket lajm, radjo e New Yorkut ka thane se asht tue u sitemue çashtja e dhanjes se materjalit ushtarak. Ne ket menyre fabrikantave amerikan t'armeve de t'iu bahet e mundun me u shite topat dhe aeroplanat si arabeve ashtu dhe izraelitve.

Lajmet e fundit mbi luftat ne Palestine i demaskojne edhe ma fort keto plane anglo-amerikane per pengimin e aplikimit te vendimit te Kombeve te Bashkueme mbi krijimin e dy shteteve te pamvarunа ne Palestine. „Spitfajeret" britanike qe i jane shite Egjyptit, bombardojne qytetin Tel-Aviv, ndersa njisi e armatosuna t'izraelitve me mitraloza te tipit „Bren", dhe me arme tjera amerikane po e pushtojne qytetin Jafa. Mire ka shkrue „Dejli Vorker" — ne Palestine po derdhet gjaku arab e izraelit sepse asht ma i lire se nafta.

## Federata botnore e grave demokratike angazhohet per zbatimin e vendimeve te Kombeve te bazhkuem kundra nxitësave te luftes se re

Ne mbledhjen e keshillit ekzekutiv te federates botnore te grave demokratike asht shqyrtue referati i kryetares se federates, z. Evzhen Koton mbi pjesemarrjen e grave ne zbatimin e vendimeve te Kombeve te bashkuem ne pikpamje te luftes kundra nxitesave te luftes se ré. Ne referat theksohet nder te tjera se qeverit e Shteteve te Bashkueme t'Amerikes, Britanis se madhe, Frances dhe shteteve tjera qe jane nen kontrollin e Vashingtonit, i kane shkele dhe po i shkelin haptas parimet mbi te cilat mbeshtetet Organizata e kombeve te bashkuem. Evzhen Koton theksoh mandej ne referatin e saje se politika paqedashese e Bashkimit Sovjetik dhe vendeve te demokracis popullore asht pengesa kryesore per realizmin e planeve agresive t'imperjalizmit dhe prandaj shtetet kapitaliste e drejtojne fushaten e tyne shpifse kundra Bashkimit Sovjetik — luftetarit ma konsegent per paqen e drejte demokratike.

Evzhen Koton ka deklarue se lufta e grave demokratike duhet te drejtohet per realizimin e ketyne qellimeve: ndalimin e propagandes se nxitesave te luftes, mprojtjen e paqes, organizimin e botes se mbas luftes ne baze te vendimeve te marruna ne Potsdam e Jalite, ndalimin qe Gjermanija te bahet perseri burim i rrezikut luftarak dhe agresjonit, ndalimin e perdorimit t'armes atomike dhe dhanjen e ndihmes popujve kolonial ne luften e tyne per lirin dhe pamvaresin kombetare.

Greqi

Simbas lajmit te radjostacjonit te Greqis se lire, te burgosunit politik nga ishulli Limnos kane shkrue nji leter ku thuhet se n'ate ishull te shkretnuem gjinden 2500 te burgosun politik te qitun ne nji grope te gjate 500 e te gjane 150 metra. Keta jane te vendosun nen çadra te shkyeme ku i shkatrron te ftoftit dhe lagshtija, shiu e era.

Nder ne — thuhet ne leter — shumica jane luftetare te levizjes popullore kundra okupatorit gjerman. Nder ne gjinden edhe 150 pleqe, 50 te ri nen 18 vjet, si dhe 500 te semunde rande.

Ne leter mandej paraqiten metodat brutale te martirizimeve te cilat i perdore roja monarko-fashiste mbi te burgosunit.

## Kapteri amerikan Makmilin, ish shifrant n'ambasaden amerikane ne Moske, refuzon te kthehet ne SH.B.A.

Agjensija Tass lajmeron:

Kapteri i ushtris amerikane Xhems Makmilin me sherbim prane atasheut ushtarak n'ambasaden amerikane ne Moske i dergoi kryetarit te Sovjetit te deputetve e punonjesve te Moskes nji leter me ket permbajtje:

„Kryetarit te Bashkis se Moskes nga kapteri i ushtris amerikane ne-shifrant i atasheut ushtarak prane ambasades amerikane ne Moske.

Para dy vjetesh erdha ne Bashkimi Sovjetik nga Shtetet e Bashkueme t'Amerikes ku kam le, jam edukue dhe kam krye shkollen. Kam qene larg politikes qe asht tash n'Amerike arme e antarve te Kongresit, senatorve dhe punedhansave ne luften e tyne te vazhdueshme per profite personale e per pushtet.

Tue jetue ne Shtetet e Bashkueme t'Amerikes, s'kame mujte as me mendue se egziston nji sistem qeverimi, siç asht ne Bashkimin Sovjetik ku bahet kujdes mbi njerin e thjeshte e qe drejtohet kah permiresimi i vazhdueshem i kushteve jetesore dhe kulteres se popullit. Kam qene i pezmatuem kur kam pa se disa grupe njerezish krijojne profite nga ajo qe u perket njerezve te thjeshte. Qyshse kam ardhe ketu ne Bashkimin Sovjetik, kam kuptue se te keqijat e sotshme te qeveris amerikane jane rezultat i sistemit te padrejte politik ne te cilin individi mund te krijoje per vehte mireqenjen tue e nenshtrue tjetrin. M'asht ba e kjarte se sistemi politik ne vend ku pasunit natyrore dhe industrija gjinden ne duer te nji grushi pasanikesh, asht padrejtesija ma e madhe.

Tue e pa popullin sovjetik, menyren e jetes dhe mendimit te tij, kam kuptue se ardhmenija i perket ketij vendit ku fitoret kulturore, teknike e shkencore i sherbejne mbare popullit. Asht fare e dijtun se kapitalistat e kane pase te kjarte qe sistemi ne te cilin gjithçka i perket popullit asht rrezik per'ta. Vetem ky fakt mund t'i spjegoje sulmet e paturpshme te kapitalistave amerikane ne vendin sovjetik.

Ne shej proteste kundra politikes antisovjetike te cilen e zbaton tash Amerika, refuzoj me u-kthye ne Shtetet e Bashkueme t'Amerikes dhe mbetem ne Bashkimin Sovjetik.

Po ket leter ia kam dergue edhe ambasadorit amerikan ne Moske zotit Smit".

## LAJME TE SHKURTA

TIRANE:

Agjensia telegrafike shqiptare lajmeron:

Me 14 te ketij muajit n'ora 16,30 nji aeroplan i panjoftun, tue ardhe nga ana e Italis, fluturoi permbi vendet Xhamili e Atil dhe mandej u-kthye po ne ate drejtim. Roja shqiptare e kufinit hapi zjarre n'aeroplanin.

Po ne ket dite n'ora 18.30 ushtaret monarkofashista greke shprazen nji granate mortaje nga bjeshka Derventi ne Greqi drejt gurit kufitar nr. 25 ne sektorin e banjes Leskovik. Projektili plasi 300 metra mbrenda ne territorin shqiptar. N'oren 21,40 ushtaret grek nga katundi Kastanje ne Greqi shprazen 4 predha nga mortaia ne drejtim te shtyllave kufitare nr. 41 e 42 ne sektorin e Kolsavices. Projektilet kane ra 50 metra mbrenda ne teritorin shqiptar.

Greqi

Simbas lajmeve t'Agejnsis Tass shtypi i Athines ne komunikatat e tija thot se per vdekjen e korespondentit te kompanis radjo-informative «Kolumbija» Xhorgj Polk jane pergjegjesa elementat fashista greke. Miku i ngusht i Polkut, korespondenti i fletores «Krishqen Sajense Monitor» Argiris, ka deklarue se gjate javeve te fundit disa persona te panjoftun i jane kercnue Polkut se do t'a vrasin «si komunist».

«Dejli Uorker» shkruen se ne fillim te ketij vjeti sherbimi informativ grek ne Neujork e ka kritikue Polkun sepse ka botue ne revisten „Herpers Magazin" nji artikull me te cilin ka demaskue korupcjonin e qeveris Greke.

ATHINE. —

Radio-stacioni i Greqis se lire komunikon se njisitat e Armates demokratike greke kane krye nji seri sulmesh ne teritorin e Epirit, Maqedonis Lindore, Trakis e Maqedonis Qendrore. Ne keto sulme monarko-fashistat kane pesue humbje te mdhaja. Ne nji vend diverzantat e Armates Demokratike kane angazhue dy skuadra mitrolozash, kane shkaterrue rrugen Janine-Konice ne gjatesi prej 300 m. dhe me 8 maj kane rrexue ne teritorin e Krushes nji aeroplan t'anmikut.

## Demaskim i delegacjonit austriak per qendrimin e padrejtë kundrejt Sllovenve te Korushkes

ÇELOVEC. —

Korispondenti i Tanjugut lajmeron:

Fletorja „Slovenski vesnik" organ i Frontes çlirimtare te Korushkes, botoi nji artikull te gjate me titull „Rrenat dhe kercnimet-argumente te tyne" me te cilin demaskon deklaratat e rrejshme te ministrit austrijak te punve te jashtme Karl Gruber - it ne konferencen e Londres e cila u mbait tash vone ne lidhje me çashtjen e Austris.

„Faktet historike mbi gjermanizimin e perdhunshem te Sllovenve te Korushkes, perndjekimet e intelektualve sllovene, ndalimi i shkollave sllovene, falsifikimi i regjistrimit te popullsis, ndalimi i zhvillimit kultural te sllovenve-te gjitha keto shkruen fletorja-simbas deklarates se Gruberit ne Londer, jane gjoja jeta e perbashket paqesore, jane ligje dhe plotsimi i detyrimeve te traktatit te Sanzhermenit". Fletorja theksoh mandej se Gruberi ka shkue aq larg ne deklaraten e tij sa u ka thane se ne Korushke ka vetem 24.000 slloven, me gjithqe ne procesin kundra Majer Kaibiçit, nazist austrijak, asht vertetue se nazistat kane pase ne plan me shpërngulë 50.000 sllovene te Korushkes.

Mandej n'artikull demaskon metodat e fligeshta te perfaqesuesave shoviniste austrijake te cilat kane gjete perkrahjen e plote te fuqive imperjaliste perendimore me rastin e shqyrtimit te çashtjes se Korushkes.

Ne fund fletorja i shpreh falenderimin Dr. Alesh Beblerit n'emen te sllovenve te Korushkes, i cili i ka demaskue rrenat dhe falsifikimet e delegates austrijake.

Botim i Keshillit Krahinuer te Frontit popullueer — Shtypshkroja Krahinore e Frontit popullueer
Pajtimet ne fletore i pranon: Administrata dhe ekspedicioni.